



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 59

2001

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.655, datë 2.11.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.521, datë 26.10.1993 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në përdorim të disa objekteve", ndryshuar me vendimin nr.289, datë 30.5.1994 të Këshillit të Ministrave.....	1857
Vendim i KM nr.666, datë 7.12.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.41, datë 27.1.1997 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin e veçantë të sportistëve të niveleve të larta"	1857
Vendim i KM nr.667, datë 7.12.2001	Për mënyrën e financimit të cilësisë sportive.....	1858
Vendim i KM nr.668, datë 7.12.2001	Për pjesëmarrjen e sektorit privat, me kontratë koncesioni, në shoqëritë anonime të ujësjellës-kanalizimeve të Bashkive të Beratit dhe të Kuçovës.....	1858
Vendim i KM nr.669, datë 7.12.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë".....	1859

Vendim i KM nr.674, datë 7.12.2001	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore	1859
Vendim i KM nr.681, datë 13.12.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.129, datë 18.3.1999 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve dhe autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre"	1860
Vendim i KM nr.683, datë 13.12.2001	Për riorganizimin e rrjetit arkivor vendor	1860
Vendim i KM nr.685, datë 13.12.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Rrëshenit.....	1861
Vendim i KM nr.686, datë 13.12.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Burrelit.....	1862
Vendim i KM nr.687, datë 13.12.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Korçës.....	1863
Vendim i KM nr.688, datë 13.12.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Shijakut.....	1864
Vendim i KM nr.689, datë 13.12.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në komunën e Zall-Herit (Bathore).....	1865
Vendim i KM nr.691, datë 13.12.2001	Për hapjen e vendkalimit të ri kufitar Rips, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Greqisë....	1866

V E N D I M
Nr.655, datë 2.11.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.521, DATË 26.10.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË DISA OBJEKTEVE", NDRYSHUAR
ME VENDIMIN NR.289, DATË 30.5.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50 të ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objektet me nr.2, 3 dhe 5 përkatësisht, klubi i rinisë nr.5, pranë shkollës "Konferenca e Pezës", klubi i rinisë, nr.9, pranë Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri" dhe klubi i rinisë nr.10, pranë Ndërmarrjes Artistike "Migjeni" në Tiranë, të parashikuara në pikën 1 të vendimit nr.521, datë 26.10.1993 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.289, datë 30.5.1994 të Këshillit të Ministrave kalojnë në administrim të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
Ku vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.666, datë 7.12.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.41, DATË 27.1.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN E VEÇANTË TË SPORTISTËVE TË NIVELEVE TË
LARTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 30 të ligjit nr.8114, datë 28.3.1996 "Për sportin", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Pika 2 e vendimit nr.41, datë 27.1.1997 të Këshillit të Ministrave shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.667, datë 7.12.2001

PËR MËNYRËN E FINANCIMIT TË CILËSISË SPORTIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fondet buxhetore, të dhëna për pagat dhe sigurimet shoqërore të sportistëve dhe trajnerëve të cilësisë së lartë sportive, të kalojnë në formën e grantit dhe të përdoren për financimin e cilësisë sportive.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për mënyrën e përdorimit të këtij granti dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr.668, datë 7.12.2001

PËR PJESËMARRJEN E SEKTORIT PRIVAT, ME KONTRATË KONCESIONI, NË SHOQËRITË ANONIME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE TË BASHKIVE TË BERATIT DHE TË KUÇOVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.8103, datë 28.3.1996 "Për privatizimin e ndërmarrjeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura" dhe të nenit 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies me kontratë koncesioni, të formës BOT, të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a. të Bashkive të Beratit dhe të Kuçovës.

2. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit janë organet shtetërore, të autorizuara për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit që, në bashkëpunim me këshilltarin ndërkombëtar, të përgatisin kontratën e koncesionit, aktet nënligjore dhe dokumentet përkatëse për përzgjedhjen e operatorit privat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M
Nr.669, datë 7.12.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 83 të ligjit nr.8492 datë 27.5.1999 "Për të huajt", me propozimin e Ministrisë të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në lidhjen nr.8 "Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë", që i bashkëlidhet vendimit nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, nga grupi II të hiqet Singapori dhe nga grupi III të hiqen Arabia Saudite, Bahreini, Omani, Katari, Kuvajti, Egjipti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.674, datë 7.12.2001

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË
QËNIEVE NJERËZORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shtetit pranë Kryeministrit, Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Informativ Shtetëror për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj strategjie.

3. Institucionet e mësipërme, sipas planveprimit të strategjisë, të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Përgjithshme, me gjyqësorin, me organizmat ndërkombëtarë të pranishëm në vendin tonë, si OSBE-ja, KE-ja, IOM-i dhe me organizatat jofitimprurëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.681, datë 13.12.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.129, DATË 18.3.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE DHE
AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË
TYRE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 dhe 21 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Paragrafi i katërt i pikës 7 të vendimit nr.129, datë 18.3.1999 të Këshillit të Ministrave ndryshon si më poshtë vijon:

"Kushti i kapacitetit minimal të depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse dhe të kalibrimit të tyre duhet të plotësohen nga subjektet, që kryejnë veprimtarinë e tregtimit të gazit të lëngshëm, sipas nenit 14 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 deri më 31.12.2002. Me plotësimin e këtyre kushteve jepet leja e tregtimit."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.683, datë 13.12.2001

PËR RIORGANIZIMIN E RRJETIT ARKIVOR VENDOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e arkivave shtetërore të qarqeve, mbi bazën e arkivave shtetërore të atyre rretheve, të cilat, me ndarjen e re administrative, janë qendra qarku.

Arkivat shtetërore të qarqeve të jenë në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

2. Arkivat shtetërorë të qarqeve administrojnë, krahas pasurisë së trashëguar, edhe dokumentet e krijuara nga institucionet shtetërore që funksionojnë në qark, si dhe fondet e institucioneve që e pushojnë veprimtarinë për shkak të rindërtimit administrativo-territorial.

3. Riorganizimin e arkivave shtetërore të rretheve, që nuk përfshihen në pikën 1, si degë të arkivave shtetërore të qarqeve, që funksionojnë pranë njësive adminstrativo-territoriale ku ato ndodhen. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave vendos kohën e shuarjes së kësaj veprimtarie.

4. Arkivat shtetërore të rretheve Mirditë, Lushnjë dhe Pogradec mbeten si vendruajtje dokumentesh në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përcakton emërtesën, procedurat dhe radhën e tërheqjes së fondeve me rëndësi historike, kombëtare nga ish-arkivat shtetërorë të rretheve, që mbeten degë të arkivave shtetërore të qarqeve.

6. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.685, datë 13.12.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E RRËSHENIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Rrëshenit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Rrëshenit.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 3200 m² tokë bujqësore, në shumën e përgjithshme prej 1 636 000 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime".
5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Rrëshenit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 158 000 (njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 14 deri në 31 dhjetor 2001.
7. Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Rrëshenit.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Lezhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA RRËSHEN**

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Preng Gjergj Melyshi	3200	480	1.636.000

**V E N D I M
Nr.686, datë 13.12.2001**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E
BURRELIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarëve që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Burrelit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Burrelit.
 3. Pronarët e pasurive e paluajtshme që shpronësohet të kompensohen në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 3864 m2 tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 2 033 700 (dy milionë e tridhjet e tre mijë e shtatëqind) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Burrelit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 121 000 (njëqind e njëzet e një mijë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 14 deri në 31 dhjetor 2001.
 7. Pagesat e pronarëve të shpronësuar të kryhen nga Bashkia e Burrelit.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Dibrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Ilir Meta**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E BURRELIT**

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Dylejman Halit Pali	483	526.32	254212.56
2	Vera Halit Pali	483	526.32	254212.56
3	Lutfie Halit Pali	483	526.32	254212.56
4	Bujar Halit Pali	483	526.32	254212.56
5	Xhevrije Halit Pali	483	526.32	254212.56
6	Fatmir Halit Pali	483	526.32	254212.56
7	Qamil Halit Pali	483	526.32	254212.56
8	Kujtim Halit Pali	483	526.32	254212.56
	Shuma	3864		2033700.48

V E N D I M
Nr.687, datë 13.12.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Korçës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Korçës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqen prej 4250 m² tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 5 318 450 (pesë milionë e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Korçës, kërkesit për shpronësim, në shumën 122 000 (njëqind e njëzet e dy mijë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 14 deri në 31 dhjetor 2001.
 7. Pagesat e pronarëve të shpronësuar të kryhen nga Bashkia e Korçës.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË KORÇËS

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Myqereme Osman Manka	1062.5	1251.4	1329612.5
2	Ridvan Osman Manka	1062.5	1251.4	1329612.5
3	Selaidin Osman Manka	1062.5	1251.4	1329612.5
4	Klarens Stefan Kote	1062.5	1251.4	1329612.5
	Shuma	4250		5318450

V E N D I M
Nr.688, datë 13.12.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E SHIJAKUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Shijakut.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Shijakut.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2350 m² tokë bujqësore, në shumën e përgjithshme prej 2 350 000 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të bashkisë së Shijakut, kërkuesit për shpronësim, në shumën 159 000 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 14 deri në 31 dhjetor 2001.
 7. Paguesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Shijakut.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Durrësit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E SHIJAKUT

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Pëllumb Asllan Keci	2.350	1.00	2.350.000
	Shuma	2.350		2.350.000

V E N D I M
Nr.689, datë 13.12.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E ZALL-HERRIT (BATHORE)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarëve, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Zall-Herrit (Bathore).
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Zall-Herrit (Bathore).
 3. Pronarët e pasurive së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 12700 m² tokë bujqësore, në shumën e përgjithshme prej 10 160 000 (dhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Komunës së Zall-Herrit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 14 deri në 31 dhjetor 2001.
 7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Zall-Herrit.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E ZALL-HERRIT

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Hajdar Ibrahim Allushi	4700	800	3760000
2	Sadik Ibrahim Allushi	4000	800	3200000
3	Qamil Mustafa Fejza	4000	800	3200000
	Shuma	12700		10160000

V E N D I M Nr.691, datë 13.12.2001

PËR HAPJEN E VENDKALIMIT TË RI KUFITAR RIPS, NË KUFIRIN SHTETËROR TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME REPUBLIKËN E GREQISË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 dhe 3 të nenit 24 të ligjit nr.8772, datë 19.4.2001 "Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Hapjen e vendkalimit të ri kufitar Rips, Sarandë në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Greqisë për komunikacion kufitar për qarkullimin e njerëzve dhe të mallrave.
2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 28.12.2001
Doli nga shtypi më 28.12.2001

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë